

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarë: Tonka Berishaj kryetare, Have Haliti dhe Fillim Skoro, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve Y.B. nga Prishtina, E.I. nga fsh. ..., Komuna e ...it, B.A. nga fsh. ..., K. e Decanit, për shkak të veprës penale kontrabandim me emigrant nga neni 170 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari Y.B. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, i akuzuari A.B. nga Peja për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale kontrabandim me migrantë nga neni 170 par. 2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë, ankesën e mbrojtësve të akuzuarve Y.B. av. R.D. , të akuzuarit B.A. , av. E.K. , të akuzuarit A.B. , përgjigjes në ankesën e Prokurorisë të mbrojtësit të akuzuarit E.I. , av. N.R. , të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.699/2015 të datës 29.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 04.05.2018, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohen si të pabazuara, ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve Y.B. , B.A. dhe e të akuzuarit A.B. , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.699/2015 i datës 29.09.2017, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.699/2015, të datës 29.09.2017, të akuzuarit Y.B. , B.A. dhe E.I. janë shpallur fajtor: për shkak të veprës penale kontrabandim me migrantë nga neni 170 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari Y.B. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, ndërsa i akuzuari A.B. për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale kontrabandim me emigrant nga neni 170 par. 2 lidhur me nenin 31 dhe 33 të KPRK-së. I akuzuari Y.B. për veprën penale kontrabandim me emigrant nga neni 170 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda 2 viteve nuk kryen vepër tjetër penale,

duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej dt. 19.03.2015 deri më dt. 29.01.2016, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 10.000 (dhjetë mijë) €, kurse për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €. I akuzuari E.I. , është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda 2 viteve nuk kryen vepër tjetër penale, duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej dt. 19.03.2015 deri më dt. 29.01.2016, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 10.000 (dhjetë mijë) €. I akuzuarin B.A. është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda 2 viteve nuk kryen vepër tjetër penale, duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej dt. 19.03.2015 deri më dt. 29.01.2016, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 5.000 (pesë mijë) €, I akuzuarin A.B. për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale kontrabandim me mingrantë nga neni 170 par. 2 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda një viti nuk kryen vepër tjetër penale, duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej dt. 19.03.2015 deri më dt. 29.01.2016, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1.000 (një mijë) €. Dënimet me gjobë të gjithë të akuzuarit janë të obliguar ti paguajnë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nëse gjobën nuk e paguajnë në afatin e caktuar, e njëjta iu zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 €, do t'i llogaritet një ditë burgim.

Të akuzuarit janë obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga 100 € secili veç e veç, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit A.H. , A.S. , Q.R. , A.Q. , Sh.H. dhe Xh.Z. , kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore-juridike.

Të dëmtuarit Z.Z. , V.R. dhe D.B. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarit Y.B. dhe E.I. janë të detyruar që të dëmtuarit H.Sh. , t'ia kompensojnë dëmin e shkaktuar në lartësi prej 4.370 €, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor, ankesa kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore-DKR në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarve t'iu shqiptohet dënim me burgim efektiv, apo të anulohet dhe lëndën të kthehet në rigjykim.

Mbrojtësi i të akuzuarit Y.B. av.R.D. , për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptojë një dënim më të ulët.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.A. , av. E.K. , për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari ta lirohet nga akuza apo ta anulohet dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

I akuzuari A.B. , për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptojë një dënim më të ulët.

Përgjigje në ankesën e prokurorisë, ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit E.I. av. N.R. , me propozim që të refuzohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/L.nr.153/18 datë 06.04.2018, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ose të anulohet dhe lëndën ta kthejë në rivendosje, ndërsa ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të Y.B. , B.A. dhe e të akuzuarit A.B. t, si dhe përgjigja në ankesën e PTH e mbrojtësi i të akuzuarit E.I. , të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit për të cilën nuk u njoftuan Prokurori i Apelit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, meqenëse të akuzuarve iu është shqiptuar dënim me kusht dhe me gjobë.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të Y.B. , B.A. dhe ankesën e të akuzuarit A.B. t, si dhe përgjigja në ankesën e PTH e mbrojtësi i të akuzuarit E.I. , si dhe shkresat tjera të lëndës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve të Y.B. , B.A. dhe ankesa e të akuzuarit A.B. t, janë të pa bazuara.

Prokuroria në ankesë pretendon, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, se nga provat materiale të administruara gjendja faktike është vërtetuar si në dispozitiv të aktakuzës, se të akuzuarit duke vepruar në grup në mënyrë të kundërligjshëm, ju kanë marrë të holla të dëmtuarve në shuma prej 3000 € deri në 5000 €, për të iu siguruar viza për udhëtim jashtë vendit, se të akuzuarit kanë vepruar në grup e jo në bashkëkryerje siç e ka ricilësuar gjykata e shkallës se parë veprën penale nën pikën e parë të dispozitivit të aktgjykimit.

Kurse mbrojtësi i të akuzuarit B.A. av. E.K. , ka pretenduar se aktgjykimi ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par. 1.2 , se aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar konform nenit 370 par.7 dhe 8 të KPPK, se gjykata e shkallës se parë, në arsyetim të aktgjykimit nuk i ka sqaruar në mënyrë të plotë faktet që i konsideron të vërtetuara, dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, sepse nuk i ka vlerësuar drejt se cilat prova kanë qenë vendimtare, por vetëm i ka përshtuar deklaratat e dëshmitarëve, pa i argumentuar me fakte konkrete, provat e administruara i ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e PTH dhe të mbrojtësit të akuzuarit B.A. nuk qëndrojnë, se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kjo gjykatë i vëren edhe sipas detyrës zyrtare që kishin me ndikuar në anulimin e aktgjykimit, aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në harmoni me dispozitat e nenit 370 par.7 dhe të KPPK-së. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara. Aktgjykimi i ankimuar përmban arsyet e duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale, të cilat arsye si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo gjykatë, sepse kanë mbështetje në provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, kurse nuk qëndrojnë pretendimet e prokurorisë se kemi të bëjmë me veprë penale të kryer në grup, se prokuroria me asnjë provë nuk i ka argumentuar elementet e veprës penale në grup, por gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka bërë rikualifikimin në veprën penale të bashkëkryerjes.

Sipas Prokurorisë gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë, se me shkeljen e ligjit penal ka ardhur gjerë të konstatimi i gabuar i gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, se të akuzuarit Y.B. dhe E.I. në prokurori dhe gjykatë kanë pranuar se i kanë kryer veprat penale në grup, duke i përshkruar rolin e secilit të akuzuar, se i akuzuari B.A. ka pasur për detyrë të i siguroj klientët dhe për atë shërbim i ka marrë nga 200 €, pasaportat ju ka dorëzuar të akuzuarve Y.B. dhe E.I. , të cilët e kanë ndarë fitimin, kurse i akuzuari A.B. ka marrë të hollat nga klientët dhe ju ka dërguar të akuzuarve Y.B. dhe E.I. , si dhe ka shkuar të klientët për të ju kërkuar borxhin për viza. Se i akuzuari E.I. në prokurori ka pranuar se ju ka mundësuar marrjen e vizave 6 personave, për atë ka marrë të holla si nga H.Sh. , D.B. , se të akuzuarit kanë bashkëpunuar një kohë të gjatë duke bashkëpunuar edhe me personat nga Shqipëria si M.Xh. , i cili bashkëpunim është vërtetuar nga masat e fshehta, si dhe udhëtimet e shpeshta në Shqipëri.

Mbrojtësi i të akuzuarit, B.A. pretendon se me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, se i mbrojturi i tij nuk ka kontaktuar me të akuzuarit e tjerë me qëllim të kryerjes së veprës penale e cila i vihet në barrë, bisedat telefonike që i ka pasur me të akuzuarin E.I. , nuk kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën është akuzuar, se nuk ka bashkëpunuar me të akuzuarit Y.B. dhe A.B. , ka punuar në kompaninë e sigurimeve "...". I akuzuari ka komunikuar me të dëmtuarin A.S. me qëllim të sigurimit të vizës por qëllimi i tij nuk ka qenë kontrabandimi për ndonjë përftim pasuror, por i dëmtuari i ka kërkuar një shërbim dhe i akuzuari ka qenë në lajthitje se është duke i ndihmuar sipas ligjit, vetëm ja ka kryer një shërbim duke ia dhënë dokumentet të akuzuarit E.I. , por para arrestimit nga ana e policisë, prindi i tij ja ka kthyer të dëmtuarit të gjitha parat, të cilin fakt e ka pohuar edhe i dëmtuari A.S. . Sa iu përket pasaportave të cilat janë gjetur në zyrën e të akuzuarit, i akuzuari ka deklaruar se nuk e ka ditur se çka ka lënë në zyrën e tij i akuzuari E.I. , nuk ka qenë në zyre, por përmes telefonit i ka treguar se po e lenë një paketë të vogël të mbY.B. ur, e kur ka kuptuar se çfarë ka lënë i akuzuari E.I. , e ka thirrur përmes telefonit dhe i ka kërkuar që ta merr atë paketë, por E.I. i është vonuar dhe policia i kanë gjetur në zyrën e tij gjatë bastisjes. Se i mbrojturi i tij nuk ka qenë i vetëdijshëm se një veprim i tillë është në kundërshtim me ligjin dhe në rastin konkret nuk është vërtetuar se me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore i mbrojturi i tij të ketë prodhuar, furnizuar, siguruar ose poseduar dokumentet të rrejshme të udhëtimit me qëllim të mundësimit të kontrabandimit me migrantë.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar pretendimet e PTH dhe të mbrojtësit të akuzuarit B.A. dhe ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, sepse nga provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dëshmitë e dëshmitarëve Astrit Hoti, Q.R. , Alban Çaka, H.Sh. , Xh.Z. , A.S. , Sh.H. etj. dhe nga provat materiale, si nga transkriptet e bisedave telefonike dhe vërtetimi mbi konfiskimin e pasaportave të akuzuari B.A. , si dhe dëgjimit të akuzuarve, drejtë ka vërtetuar se i akuzuari B.A. dhe të tjerët, me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë pasurore, kanë prodhuar, furnizuar dhe siguruar dokumente të rrejshme të udhëtimit për persona të ndryshëm me qëllim të mundësimit të kontrabandimit e migrantë, në atë mënyrë që me dt. 05.09.2014, dëshmitari A.H. , ishte takuar me të akuzuarin Y.B. , nga i cili kishte blerë vizën shëngen për 3200 €, dhe me rastin e kalimit të pikës kufitare në Aeroportin e Prishtinës “Adem Jashari” ishte ndaluar nga personat zyrtar, për shkak se viza kishte rezultuar e falsifikuar, ashtu që të akuzuarit gjatë tërë kohës kanë bashkëpunuar në mes veti, vizat i kanë siguruar duke grumbulluar të dhëna, foto dhe një shumë të hollave nga personat që kanë qenë të interesuar të udhëtojnë, pastaj kanë shkuar në Shqipëri ku kanë bërë sigurimin e vizave të falsifikuara, duke bashkëpunuar me personat nga Shqipëria si Xh.Ç. dhe M.Ç. , ndërsa i akuzuari A.B. , ka komunikuar me personat që kanë qenë viktimat të kontrabandimit, nga ta kanë marrë të hollat dhe një numër të dokumenteve, duke ja dërguar të akuzuarit Y.B. , nga kanë vendosur leje qëndrim gjermane me nr. Serik ..., të vendosur në pasaportën e të dëmtuarit Q.R. , për të cilën leje qëndrimi i akuzuari E.I. kishte kërkuar 3500 €, pastaj leja qëndrimi gjerman me nr. serik ... e vendosur në emër të dëmtuar Sh.H. për të cilin ja kishte kërkuar 2500 €, leja e qëndrimit gjerman e vendosur me nr. serik D64972702 në pasaportën e të dëmtuarës V.R. j e cila kishte paguar 2000 €, leja e qëndrimit gjerman e vendosur në pasaportën e dëshmitares Z.Z. , për të cilin dëshmitari Xh.Z. kishte paguar 4000 €, të cilat pasaporta janë gjetur dhe sekuestruar në zyrën e të akuzuarit B.A. në ..., si dhe leja e qëndrimit gjerman me nr serik ..., në emër të dëshmitarit H.Sh. , i cili kishte paguar 4370 €, dhe pas sekuestrimit edhe ekspertimit të tyre kanë rezultuar se janë të falsifikuara, gjithashtu të akuzuarit në këtë mënyrë kanë bërë vizën edhe për dëshmitarët, A.Ç. i cili kishte paguar 3800 €, kurse A.S. 5000 €.

Gjithashtu i akuzuari A.B. , me dashje i kishte ndihmuar të akuzuari Y.B. t, E.I. dh B.A. në veprën penale Kontrabandim me migrantë nga neni 170 par. 2 lidhur me nenin 31 dhe 33 të KPRK-së, duke komunikuar përmes telefonit me persona të ndryshëm rreth pagesës për sigurimin e vizave për të udhëtuar jashtë vendit.

Gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, për veprën penale nën pikën e parë të dispozitivit të aktgjykimit, e aprovon edhe kjo gjykatë, se gjatë bastisjes së zyrës së të akuzuarit B.A. , në zyrën e tij janë gjetur 4 pasaporta të personave të cilët kanë qenë të interesuar për sigurimin e vizave, se i akuzuari ka pranuar se nga i dëmtuari A.S. i ka marrë shumën prej 5000 euro për të ia dorëzuar E.I. , të cilat para ja ka kthyer të dëmtuarit pas bastisjes së zyrës së tij, gjithashtu edhe nga transkriptet e bisedave telefonike të zhvilluar me të akuzuarin E.I. vërtetohet se kanë biseduar për sigurimin e vizave, ndër të tjera i akuzuari B.A. është përgjigjur të akuzuarit E.I. duke i thënë ”ngom unë u takova me të” pastaj vazhdon “pesë duhet me i shti sigurve, e për mi shti pesë duhet me shkuar edhe ndër katër, nuk bënë me pas limit”, këta kanë biseduar për çmimin që duhet të paguajnë personat e interesuar për sigurimin e vizës për të udhëtuar jashtë vendit. Pasta i akuzuari B.A. ka komunikuar me të akuzuarin Y.B. , të cilit i tregon se e ka thirr A. dhe i ka thënë për sigurimin e vizës edhe për vllaun A.H. n, pastaj ka

transkriptet të bisedave telefonike në mes të katër të akuzuarve, gjë që e vërtetojnë faktin se i akuzuari B.A. dhe të gjithë të akuzuarit tjerë kanë qenë të involvuar në kryerjen e veprës penale.

Se nuk është kontestuese se të gjithë të akuzuarit kanë pranuar se janë marrë me sigurimin e vizave për persona të ndryshëm, për veç të akuzuarit A.B. por janë arsyetuar, se nuk kanë qenë në dijeni se vizat janë të falsifikuara dhe nuk kanë vepruar si grup, por vetëm ju kanë siguruar dokumente me qëllim të mundësisimit të udhëtimit jashtë vendit.

Gjykata e Apelit, vlerëson se mbrojtja e të akuzuarit B.A. , është në kundërshtim me dëshminë e gjithë dëshmitarëve dhe provave tjera materiale me qëllim të shmangies se përgjegjësisë penale, se ai së bashku me të akuzuarit tjerë me qëllim të fitimit të pasurisë në mënyrë të kundërligjshme për një periudhë të gjatë kohore, ju kanë marrë personave të ndryshëm para për të iu siguruar viza gjermane për të udhëtuar jashtë vendit, të cilat kanë rezultuar se kanë qenë të falsifikuara, e kjo vërtetohet nga dëshmitë e dëshmitarëve, nga traskriptet e bisedave telefonike, vërtetimi mbi konfiskimin e pasaportave të konfiskuara në zyrën e të akuzuarit B.A. , i cili ka pranuar se dëshmitarit A.S. ja kishte marrë 5000 euro, për të ia dhënë akuzuarit E.I. , por e ka mohuar se e ka ditë se ato para jepen për sigurimin e vizave për udhëtim, ashtu që nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtësit se i akuzuari B.A. nuk ka qenë i vetëdijshëm se një veprim i tillë është në kundërshtim me ligjin. Gjykatës se shkallës së parë, në mënyrë të saktë i ka vërtetuar të gjitha faktet relevante, nuk ka lenë dilema, arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë i aprovon edhe kjo gjykatë.

Prokuroria pretendon, se gjykata e shkallës së parë, ka shkelur ligjin penal kur ka bërë ricilësimin e veprës penale nga nenin 170 par. 6 të KPRK-së, në nenin 170 par. 2 të KPRK-së, me arsyetim se nuk kemi të bëjmë me vepër penale të kryer në grup, se sipas gjykatës kemi të bëjmë me bashkim ad hoc të kryerjes së kësaj vepre penale, ku secili ka pasur përfitim për vete e jo në grup.

Gjithashtu mbrojtësi i të akuzuarit, B.A. , konsideron se me asnjë provë nuk është vërtetuar dashja e të mbrojturit të tij në kryerjen e veprës penale, prokuroria gjate shqyrtimit gjyqësor nuk ka arritur të provojë se i mbrojturi i tij me veprime konkrete ka tentuar të shkaktoj pasojën e dëshiruar për çka është shkelur ligji penal dhe parimi i përgjegjësisë penale, prokuroria nuk ka arritur të vërtetoj elementin qenësor dashjen me qëllim të kryerjes së veprës penale e cila i vihet në barrë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka administruar të gjitha provat, konform dispozitave të nenit 360 par.2 të KPPK-së, pas vlerësimit të tyre ka nxjerrë konkludim të drejtë, duke bërë ricilësimin e veprës penale për të akuzuarit Y.B. , B.A. dhe E.I. në veprën penale kontrabandim me migrantë në neni 170 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa për të akuzuarin A.B. në veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale kontrabandim me emigrant në neni 170 par. 2 lidhur me nenin 31 dhe 33 të KPRK-së, të cilin vlerësim si të drejtë e aprovon edhe kjo gjykatë, kurse pretendimi i mbrojtësit të akuzuarit B.A. se nuk është vërtetuar elementin qenësor dashja është i pa bazuar.

Prokuroria pretendon se vendimi mbi dënimin ndaj të akuzuarve është i papranueshëm, se gjykata me rastin e matjes së dënimit si rrethana lehtësuese ka marrë faktin se të akuzuarit më parë nuk kanë qenë të dënuar, sjelljet korrekte në gjykatë, i cili fakt nuk qëndron sepse gjatë

shqyrtimit gjyqësor të akuzuarit Y.B. , për sjellje të pahijshme disa here i është tërhequr vërejtja, kurse si rrethana rënduese për të akuzuarin Y.B. dhe E.I. ka marrë parasysh faktin se kanë pasur rol aktiv dhe kontributi i tyre ka qenë më i madhe në kryerjen veprës penale, kur për të akuzuarin B.A. dhe A.B. nuk ka gjetur rrethana rënduese, duke mos i marrë parasysh rrezikshmërinë e veprave penale, pasojën e rëndë, mungesën e pendimit për kryerjen e veprave penale dhe me një dënim kaq të ulët nuk mundë të arrihet qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit, B.A. vlerëson se dënimi me gjobë është tejte i lartë, nuk përputhet me gjendjen faktike të veprimeve inkriminuese të akuzuarit, propozon që gjykata e shkallës së parë nëse gjen se nuk ka shkelje procedurale dhe se vërtetimi i gjendjes faktike është bërë në mënyrë të drejtë dhe të plotë që dënimin me gjobë ta ndryshoj dhe të njëjtit, duke e pasur parasysh gjendjen e vështirë financiare, nuk është në marrëdhënie punë dhe për mos me rrezikuar gjendjen e familjes së tij, ti shqiptoj një dënim me gjobë më të ulët.

Mbrojtësi i të akuzuarit Y.B. , ka propozuar që duke pasur parasysh gjendjen familjare, të akuzuarit ti shqiptohet një dënim një dënim më i ulët me gjobë që mos të i rrezikohet gjendja ekonomike e familjes së tij, ndërsa dënimi me kusht i shqiptuar dhe dënimi me gjobë për veprën penale nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, të vërtetohet.

I akuzuari A.B. , ka propozuar që dënimi i shqiptuar me gjobë ti ulët dhe ti mundësohet që pagesa të bëhet me këste, ndërsa dënimi me kusht i shqiptuar të vërtetohet.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të lartësisë se dënimit ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh se asnjëri nga të akuzuarit më parë nuk ka qenë i dënuar, të gjithë kanë pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit, i akuzuari Y.B. e ka pranuar fajësinë për veprën penale nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, ndërsa si rrethana rënduese, për të akuzuarin Y.B. dhe E.I. se kanë kontribuar më shumë në kryerjen e veprës penale, ndërsa në ankesat e ushtruara nga prokuroria dhe nga mbrojtësit e të akuzuarve nuk theksohet edhe ndonjë rrethanë tjetër rënduese apo posaçërisht lehtësuese, të cilat kishin me ndikuar që të akuzuarve ti iu shqiptohet dënim më i ashpër siç pretendon prokuroria e shteti në ankesë, apo dënime më të ulëta më gjobë siç pretendojnë mbrojtësit e të akuzuar Y.B. dhe E.I. dhe i akuzuari A.B. në ankesa. Rrethanat lehtësuese që i ka marrë parasysh gjykata e shkallës së parë për të akuzuarit me rastin e caktimit të dënimit, i aprovon edhe kjo gjykatë. Për këto arsye Gjykata e Apelit vlerëson se dënimi që i është shqiptuar të akuzuarve nga gjykata e shkallës së parë, me kusht dhe me gjobë janë në harmoni me rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, prandaj duke i pas parasysh rrethanat që u theksuan më lartë, kjo gjykatë gjen se dënimet e shqiptuara janë në funksion të parandalimit të kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarve do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së.

Nga çka u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.158/2018, më 04.05.2018**

Procesmbajtëse,  
Leonita Lajqi

Kryetare e kolegjit,  
Tonka Berishaj

Anëtarët e kolegjit:

1. Have Haliti \_\_\_\_\_
2. Fillim Skoro \_\_\_\_\_